

RELACION

PËR

PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES FINANCIARE, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË, DHE CASSA DEPOSITI E PRESTITI S.P.A., PËR PROGRAMIN E ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL NËPËRMJET INOVACIONIT”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe *Cassa Depositi e Prestiti S.p.A.* për programin e arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit, për akordimin e një huaje të butë, në vlerën 5 milionë euro.

Kjo marrëveshje vjen në vijim të marrëveshjes qeveritare dypalëshe për programin në fjalë, ratifikuar me ligjin nr.51/2017, “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë, për programin “Në mbështetje të arsimit dhe formimit (AFP) nëpërmjet inovacionit”.

Synimi i programit është të përmbushë vizionin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (SKPA) 2014 - 2020, për të pasur një ekonomi konkurruese dhe një shoqëri gjithëpërfshirëse, që mbështetet në aftësi më të larta dhe punësim më të mirë për gjithë gratë e burrat deri në vitin 2020, në sektorët prodhues, ku Shqipëria ka një potencial të madh dhe Italia ka një vlerë të shtuar të konsiderueshme.

Rezultatet e pritshme janë:

- i. Organizimi dhe zhvillimi në mënyrë të plotë i Shkollës Bujqësore multifunkionale të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) në Fier dhe përmirësimi e riorganizimi i shkollës së AFP-së në Lushnjë;
- ii. Zhvillimi dhe aplikimi i kurrikulave të AFP-së të orientuara nga tregu;
- iii. Ndërtimi i marrëdhënieve të qëndrueshme dhe të përshtatura sipas kushteve, ndërmjet shkollës multifunkionale të AFP-së dhe sektorit privat;

- iv. Sigurimi i koherencës me financimin e IPA II për sektorin e punësimit dhe aftësive.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është në përputhje me programin e qeverisë 2017 – 2021, i cili ka vënë fokusin te punësimi dhe zhvillimi cilësor i forcës së punës, në përputhje me vizionin dhe direktivat e Bashkimit Evropian, Strategjinë Evropiane të Punësimit 2020, si dhe kërkesat për integrimin evropian të Shqipërisë në EU.

Ky projektligj është pjesë e programit analitik të projektakteve për vitin 2018.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Nëpërmjet këtij projektligji synohet ratifikimi i marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe *Cassa Depositi e Prestiti S.p.A.*, për programin e arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit, për akordimin e një huaje të butë, në vlerën 5 milionë euro.

Sigurimi i këtij financimi garanton mbështetjen dhe fuqizimin e dy shkollave profesionale me drejtim bujqësinë, veterinarinë, mekanikën bujqësore etj., të cilat janë shumë të rëndësishme për ekonominë e vendit tonë dhe, sidomos, në rajonin ku këto shkolla kryejnë aktivitetin e tyre.

Rezultatet e pritshme të programit AFP përfshihen në një qasje të plotë për:

- A.** ngritjen e qendrave shumëfunksionale bujqësore të ekselencës (shkolla në Fier) duke menaxhuar e organizuar në mënyrë efikente edhe shkollën teknike të Lushnjës, e rikualifikuar siç duhet në sektorin e agro-mekanikës.

Aktivitetet e detajuara për çdo rezultat të pritshëm të programit AFP do të përfshijnë ndërhyrje fizike dhe jofizike, që mund të përmbledhen në 4 komponentët e mëposhtëm:

1. *Rehabilitimi i infrastrukturës;*
2. *Blerje mallrash (Pajisje & Laboratorë);*
3. *Asistencë institucionale teknike;*
4. *Asistencë për ministrinë e linjës.*

B. zhvillimin e kurrikulave të AFP-së, të orientuara nga tregu i punës;

Programi do të ndërhyjë në secilin prej tri niveleve të ofertës AFP në Shkollën e Ekselencës, me qëllim që të jetë në gjendje të adresojë të gjitha boshllëqet e identifikuar në lidhje me aftësitë në sektorin e bujqësisë dhe atë të përpunimit agro-ushqimor. Përzgjedhja dhe përgatitja do të kryhen në bashkëpunim të ngushtë me sektorin privat, që ka një perspektivë më të gjerë për orientimin e tregut dhe do të jenë:

1. Kurrikulat AFP të nivelit të arsimit të mesëm;
2. Kurrikulat AFP për kurse afatshkurtra;
3. Kurrikulat AFP post - sekondare;
4. Trajnim trajnerësh.

C. futjen në kuadrin e sistem *dual* (të dyfishtë) funksional lidhjet e qendrës shumëfunksionale me sektorin privat, sidomos në bujqësi dhe në sektorin e përpunimit agro-ushqimor.

Ç. mundësimin e ngritjes së marrëdhënieve efikente, të përshtatura specifikisht dhe të qëndrueshme:

1. Shërbime të shkollës AFP për palë të treta;
2. Pilotimi i ndërtimit të një pakti territorial për AFP-në dhe punësimin (PTAFP)

Autoritetet shqiptare mund t'i ofrojnë shkollës AFP:

- i. grante dhe skema mikrokredie për të rinjtë sipërmarrës bujqësorë (që vijnë kryesisht nga profile postsekondare);
- ii. skema të Shërbimit Kombëtar të Punësimit;
- iii. akreditim për realizimin e moduleve të trajnimit për shërbime zgjerimi;
- iv. bursa;
- v. praktika profesionale të posaçme me bursë, praktikë profesionale dhe mundësi gjetjeje pune për nxënës në nevojë.

Ndërmarrjet italiane dhe asistencë teknike AFP mund t'i ofrojnë shkollës AFP:

- i. trajnime ndërkombëtare;
- ii. gjetje pune;
- iii. binjakëzim me shkolla të tjera AFP;
- iv. shkëmbim të praktikave të mira në lidhje me përfshirje për punë të nxënësve në nevojë.

D. maksimizimin e përputhshmërisë me financimin e IPA II për to në sektorin e punësimit dhe aftësive.

Me qëllim që të sigurohet koherencë me mbështetjen buxhetore të IPA II për sektorin e punësimit dhe aftësive, në lidhje me komponentin AFP, programi do të mbështetet në të njëjtët tregues si te dokumenti i veprimit të BE-së për sektorin social, të punësimit dhe aftësive lidhur me objektivat e përgjithshme dhe specifike.

1. *Menaxhim i programit;*
2. *Shërbime teknike;*
3. *Shërbime prokurimi;*
4. *Komunikimi dhe vizibiliteti.*

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është hartuar në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës, si dhe të nenit 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Marrëveshja financiare është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave, me vendimin nr.195, datë 4.4.2018, dhe është nënshkruar ndërmjet palëve. Në përputhje me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, marrëveshja do t’i nënshtrohet procedurës së ratifikimit.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk synon përafrimin e legjislacionit me *Acquis Communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji parashikon ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe *Cassa Depositi e Prestiti S.p.A.* për programin e arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit, për akordimin e një huaje të butë, në vlerën 5 milionë euro.

Marrëveshja financiare i bashkëlidhet projektligjit dhe përmban 20 nene dhe 6 shtojca.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është përgatitur nga strukturat përkatëse pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Projektligji është dërguar për mendim pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrisë së Drejtësisë.

Të dyja këto institucione janë shprehur dakord.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Kredia e ndihmës, e akorduar nga qeveria italiane, nëpërmjet Institucionit Financiar Italian Administrator të Fondit Qarkullues, ka shumën 5 milionë euro. Financimi që akordohet nëpërmjet kësaj marrëveshjeje ka termat financiare të mëposhtëm:

- | | |
|---------------------------------|--|
| - Shuma | 5 000 000 milionë euro; |
| - Maturimi | 22 vite; |
| - Periudha pa pagesë principali | 120 muaj, duke filluar nga data e disbursimit të parë; |
| - Norma e interesit | 0.00% p.a. |

Projekti është pjesë e parashikimeve buxhetore për periudhën 2018 – 2020, në pasqyrën 12, “Parashikimi i investimeve të huaja sipas projekteve”.

KËSHILLI I MINISTRAVE